

Programi IPA 2010 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë

***Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të
Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin dhe
Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar Mjedisor***
(EuropeAid/I 30987/C/SER/AL)

**Formular Kërkese për
Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
Aktiviteti C.3**

Dokumenti Përfundimtar



Projekti është
financuar nga Bashkimi
Evropian



Titulli i Projektit: Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin e Ligjeve dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar Mjedisor
Numri i Projektit: Europe Aid/130987/C/SER/AL;
Kontrata nr. 2011/275-693
Vendi: Republika e Shqipërisë

	Përfituese	Kontraktor
Emri:	Ministria e Mjedisit	Grontmij A/S
Adresa:	Rr. Durrësit, Nr 27, Tiranë, Shqipëri	Granskoven 8 DK-2600 Glostrup
Person i Kontaktit:	Adriana Sokoli	Paolo Bacca
Telefon:	+355 4 2270622	+355 4 2226493
E-mail:	Adriana.Sokoli@moe.gov.al	Paolo.Bacca@selea.al

Data e Raportit: Qershor 2014
Titulli: **Formular Kërkese për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**
Autorët: Alma Bako, Erjola Muka & KurtTerpgaard-Jensen
QA/QC Paolo Bacca

Mirënjohje

Ekipi i projektit dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij për të gjithë personat dhe ekspertët nga të gjitha institucionet dhe palët e interesuara të përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe informacionit dhe të gjithë personat dhe organet që kanë mbështetur zhvillimin e këtij Manuali. Falënderime të veçanta shkojnë për drejtuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Ky raport është përgatitur nga një ekip që punon për Grontmij. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të Grontmij dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të merren për të pasqyruar mendimet dhe politikat e Komisionit Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. ___ Prot.

Datë _____

Kërkesë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Numri i Identifikimit të Kërkesës _____

1. Emri i zhvilluesit/kërkuesit

Person Juridik _____
(Kompania, Adresa)

Person Fizik _____
(Emri, Mbiemri, Adresa)

2. Projekti: _____
*Titulli i projektit të propozuar referuar shtojcave I dhe II të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.
2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"*

3. Vendndodhja _____

Qark/Bashki/Komunë _____

Emri, titulli i personit të autorizuar _____

(Firma, Vula)
Data _____

Tarifa e paguar në datë _____

Formulari i Kërkesës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) duhet të plotësohet nga zhvilluesi për përfundimin e miratimit mjedisor për **projektet e reja të zhvillimit**, të vlerësuara për të minimizuar ose shmangur ndikimet e mundshme mjedisore.

Në rast se informacioni i paraqitur nga zhvilluesi do të konsiderohet i pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me këtë Formular Kërkese, si dhe jo sipas legjislacionit përkatës për VNM, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) mund të kërkojë informacion shtesë.

Për informacion të mëtejshëm, duhet t'i referoheni si më poshtë:

- Ligjit Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligjit Nr. 10440, datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- VKM Nr. 13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së VNM"

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1.1 Informacion mbi zhvilluesin

Personi Fizik/Juridik	
Përfaqësuesi i Autorizuar/Personi Kontakt Emri dhe Mbiemri	
Pozicioni në Kompani	
Adresa	
Telefoni	
Faksi	
E-mail	

1.2 Informacion për ekspertin e VNM

Eksperti/ekspertët e VNM që kanë hartuar raportin e VNM: Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Tel	
Faksi	
E-mail	
Numri dhe data e Çertifikatës së Ekspertit/ekspertëve	
Personi Juridik/Fizik tregtar i liçensuar nga QKL per veprimtarine III.2.A	

1.3 Informacion mbi Projektin

Titulli i Projektit

Shënim: Ju lutemi përfshini emrin e projektit/aktivitetit (siç është regjistruar zyrtarisht) në rast të çdo ndryshimi ose shtese në projektet e listuar në Shtojcën I apo II të ligjit tëVNM, të liçensuar paraprakisht, që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin, projekte që janë zbatuar ose në proces zbatimi

Vendndodhja/Adresa e projektit te parashikuar

Koordinatat e vendndodhjes Koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUSS KRÜGER: 1942_GK_ZONE_4, shoqeruar me harte

topografike te gjeoreferuar

1.4 Liçensat e përfutuara

Listoni lejet/liçensat e përfutuara, për rastet kur kërkohet ndryshim ose shtese në projektet e listuar në Shtojcën I apo II të ligjit të VNM, të liçensuar paraprakisht, që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin, projekte që janë zbatuar ose në proces zbatimi

Leja/Liçensa	Nr.	Data e Lëshimit	Periudha e vlefshmërisë

Shënim: Përfshini të gjitha lejet, liçensat e vlefshme bashkëlidhur Formularit të Kërkesës

1.5 Pronësia e tokës

Për rastet kur kërkohet ndryshim ose shtesë në projektet e listuar në Shtojcën I apo II të ligjit të VNM, të liçensuar paraprakisht, që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin, projekte që janë zbatuar ose në proces zbatimi, të jepet emri dhe adresa e pronarit/pronarëve të tokës (nëse janë ndryshe nga ato të zhvilluesit)

Emri dhe Mbiemri i pronarit/pronarëve	
Të dhëna për pronësinë e tokës/kontratën e qerasë sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP	

1.6 Pronësia e impiantit/aktivitetit

Për rastet kur kërkohet ndryshim ose shtesë në projektet e listuar në Shtojcën I apo II të ligjit të VNM, të liçensuar paraprakisht, që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin, projekte që janë zbatuar ose në proces zbatimi, të jepet emri dhe adresa e pronarit/pronarëve të projektit/impiantit ku kryhet aktiviteti si dhe informacion për kontratën e qerasë në se zhvilluesi nuk është pronari

Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Informacion mbi kontratën (Qiradhënësi dhe Qiramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të Kontratës, periudha e vlefshmërisë)	

Shënim: Përfshini një kopje të kontratës së qerasë bashkëlidhur Formularit të Kërkesës së VNM

2 INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR TË GJITHË KËRKUESIT

2.1 Informacion mbi projektin e propozuar

Përshkruani shkurtimisht projektin e propozuar sipas tabelave respektive më poshtë dhe tregoni vendndodhjen e informacionit të detajuar në Projektin Teknik (Kapitull, Faqe, Aneks) sipas Shënimeve respektive të secilës tabelë më poshtë:

Qëllimi i projektit të propozuar

Listoni aktivitetet për të cilat aplikoni:

- 1.
- 2.
- 3.....

Listoni alternativat e marra në konsideratë, alternativat e projektit dhe ndikimet e tyre shoqëruese në mjedis gjatë planifikimit të projekti, duke përfshirë opsionin “Mos bëj asgjë”

Shënim: Siguroni në Projektin Teknik informacion rreth alternativave të marra në konsideratë gjatë planifikimit të projektit përse i përket përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret, duke spjeguar arsyet përse është përzgjedhur propozimi i paraqitur, duke përfshirë edhe arsyet mjedisore

Vendndodhja e projektit

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike të gjeoreferuar sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit

informacion i shkurtër për qendrat e banuara dhe distanca nga zona ku propozohet të zbatohet projekti, pasqyruar edhe në hartë topografike të gjeoreferuar

Shënim: Informacion i detajuar në Projektin Teknik për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe me të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna), që administron territorin ku propozohet projekti

Tregoni në Projektin Teknik, skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit

Listoni proceset ndërtimore dhe teknologjike

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik proceset ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Listoni infrastrukturën e nevojshme dhe/ose ekzistuese

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Program për ndërtimin

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Listoni mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit

Listoni lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)

Listoni lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit

Shënim: Në rast të lidhjeve të mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit, siguroni informacion dhe përshkruajeni në Raportin Teknik

Listoni lëndët e para që do të përdorni gjatë funksionimit, operimit

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik lëndët e para që do të përdoren gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre

Listoni aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit

Shënim: Përshkruani në Projektin Teknik aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj

Listoni lejet dhe liçensat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin

në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/liçensimin e projektit

2.2 Informacion për ndërveprimin e projektit të propozuar me mjedisin

Përshkruani shkurtimisht në tabelat respektive më poshtë ndërveprimin e projektit të propozuar me mjedisin dhe tregoni vendndodhjen e informacionit të detajuar në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), (Kapitull, Faqe, Aneks) sipas Shënimeve respektive të secilës tabelë më poshtë:

Listoni mbulesën bimore të sipërfaqes, ku propozohet të zbatohet projekti

Shënim: Përshkruani në mënyrë të detajuar në Raportin e VNM mbulesën bimore të sipërfaqes, ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe

Tregoni praninë e burimeve ujore

Shënim: Siguroni informacion të detajuar në Raportin e VNM për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj

Listoni ndikimet e mundshme negative në mjedis të projektit

Shënim: Përshkruani në Raportin e VNM ndikimet e mundshme negative të identifikuar në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër

Listoni shkarkimet e mundshme në mjedis

Shënim: Përshkruani në Raportin e VNM shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve

Informacion i shkurtër për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Shënim: Siguroni informacion të detajuar në Raportin e VNM për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Informacion i shkurtër për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shënim: Përshkruani në Raportin e VNM shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të

Informacion i shkurtër mbi mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar

--

Shënim: Përshkruani në Raportin e VNM mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin

Listoni masat kryesore të mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Shënim: Përshkruani në Raportin e VNM masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Tregoni nëse ka ndonjë ndikim të mundshëm në mjedisin ndërkufitar

Shënim: Nëse ka ndonjë ndikim të mundshëm në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë), përshkruajeni atë në Raportin e VNM

2.3 Dokumentet që duhet të paraqiten së bashku me këtë Formular Kërkese

Përshkrim i projektit të propozuar
Raport Paraprak i VNM
Një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës

3 KËRKESA SPECIFIKE NË RAST TË VNM TË THELLUAR

3.1 Çështje që duhet të Adresohen në VNM e Thelluar

Ju lutemi konfirmoni në tabelën e mëposhtme çështjet respektive që adresohen në VNM e Thelluar dhe tregoni vendndodhjen në Raportin e Thelluar të VNM (Kapitull, Faqe, Aneks):

ÇËSHJTJET RESPEKTIVE QË DUHEN ADRESUAR	PO	JO
Kërkesat e saj, të institucioneve, publikut dhe OJF të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen në raportin e thelluar të VNM		
Një sqarim të përmbledhur për kërkesat e procedurës së thelluar të VNM, deri në paraqitjen e aplikimit në QKL dhe dhënien e Deklaratës Mjedisore		
Detyrimin për informimin, konsultimin dhe dëgjuesën me publikun dhe OJF të raportit të thelluar të VNM dhe konsiderimin e mendimeve të dhëna në raportin përpara se të paraqitet në QKL		
Analizimin e te paktën dy alternativave për zbatimin e projektit		
Udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM		
Udhëzime për masat për mbrojtjen e mjedisit që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM		
Strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM, në përputhje me Shtojcën II të VKM Nr. 13 datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së VNM"		
Faktin që projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për këtë rast		

3.2 Dokumentet që duhet të Paraqiten së bashku me këtë Formular Kërkese (në rast të VNM të Thelluar)

Raporti i thelluar i VNM, i cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Shtojcës II të VKM Nr. 13 datë 04.01.2013 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së VNM"
Përmbledhje Jo Teknike e raportit të VNM
Projekti Teknik
Informacion për informimin dhe konsultimin me publikun dhe palët e tjera, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM
Një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës

4 DEKLARATË

DEKLARATË

Duke nënshkruar këtë deklaratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe akteve nënligjore përkatëse, konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë kërkesë është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Unë nuk kam vërejtje lidhur me bërjen publike të kësaj kërkesë, për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare.

Emri i nënshkruesit: _____

Pozicioni brenda Kompanisë: _____

Firma: _____ Data: _____

Vula e
Kompanisë/Zhvilluesit